**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**
**BORDI**

# VENDIM

**Nr. 85, datë 31.05.2021**

## MBI
## MIRATIMIN E FORMULARIT TË "RAPORTIT EVROPIAN TË AKSIDENTEVE"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, të Ligjit nr. 9572 datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", i ndryshuar dhe nenit 14, të Ligjit nr. 32/2021 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit", Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I :**

1. **Miratimin e formularit të "Raportit Evropian të Aksidenteve", sipas formatit bashkëlidhur.**
2. **Shoqëritë e sigurimit, duke filluar nga data 1 korrik 2021, sëbashku me policën e sigurimit, duhet t'i dorëzojnë të siguruarit formularin e "Raportit Evropian të Aksidenteve".**
3. **Shoqëritë e sigurimit, të marrin masa që të sigurojnë pajisjen me këtë formular të të gjithë personave të siguruar.**
4. **Ngarkohet Departamenti i Çështjeve Juridike dhe Licencimit, për njoftimin në zbatim të këtij vendimi.**

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

| | |
|---|---|
| **KRYETAR** | **DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV** |
| **Olsi ÇOKU** | **Ervin METE** |

(Ligji 32/2021 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit")

# RAPORTI EVROPIAN I AKSIDENTEVE

Ky formular i nënshkruar nga të dy drejtuesit e mjeteve konsiderohet i vlefshëm dhe përdoret për dëmshpërblimin e shpejtë në rast të aksidenteve rrugore nëse ka dëme ndaj pronës në vlerë deri 30 000 (tridhjetëmijë) lekë.

| | | | |
|---|---|---|---|
| **1. Data** e aksidentit | Ora | **2. Vendi** i aksidentit ( rrethi, qyteti, adresa ). | **3. Dëme** shëndetësore<br>Po ☐ Jo ☐ |

**4. Dëme** materiale mjeteve te tjera përveç A ose B:
Po ☐ Jo ☐ *

**5. Dëshmitarë**: emër, mbiemër, adresa, tel. (saktëso nëse janë pasagjerë në mjetin A ose B).
Po ☐ Jo ☐ Nëse po, plotëso mbrapa

## Mjeti A (i dëmtuar)

A

**6. I siguruari** (kontrollo policën e sigurimit)
Emër______________________
Mbiemër ____________________
Adresa______________________
Shteti______________________
Email_______________________
Tel.________________________

**7. Automjeti**
Marka dhe tipi_________________
Targa ose nr. i shasisë___________

**8. Shoqëria e sigurimeve** ___________
**Nr. i Policës**____________________
Nr. i Kartonit Jeshil________________
(për të huajt) (sigla e vendit) ( nr. )
**Kontrata e sigurimit** | e vlefshme deri
ose **Kartoni Jeshil** | _______________
A është vetë mjeti i siguruar ( Kasko ) ?
**Po** ☐ **Jo** ☐

**9. Drejtuesi** (Kontrollo dokumentet)
Emër_________________________
Mbiemër_______________________
Adresa________________________
Shteti_________________________
Tel. email_______________________
Leje drejtimi nr. _______________
Kategoria_____ lëshuar nga___________
____________________më____________
E vlefshme deri më_______________

**10. Shëno me kryq pikën fillestare të goditjes.**



**11. Dëme materiale të dukshme.**
______________________
______________________
______________________

**14. Vërejtje**______________________________
______________________________________
______________________________________

## 12. Rrethana të aksidentit

**Vendos një "X" në secilën nga kutitë që përshkruan aksidentin**

| A | | | B |
|---|---|---|---|
| ☐ | **1** | **I ndaluar/I parkuar** | ☐ |
| ☐ | **2** | **nisej pas një ndalimi** | ☐ |
| ☐ | **3** | **përpiqej të ndalonte** | ☐ |
| ☐ | **4** | **dilte nga parkimi, vend privat ose rrugë me përdorim privat** | ☐ |
| ☐ | **5** | **hynte në parkim, vend privat ose rrugë me përdorim privat** | ☐ |
| ☐ | **6** | **hynte në një shesh me kah rrotullues** | ☐ |
| ☐ | **7** | **qarkullonte në një shesh me kah rrotullues** | ☐ |
| ☐ | **8** | **godiste një mjet, që ecte në të njëjtin drejtim dhe në të njëjtën rradhë** | ☐ |
| ☐ | **9** | **godiste një mjet, që ecte në të njëjtin drejtim, por në rradhë tjetër** | ☐ |
| ☐ | **10** | **ndërronte korsi** | ☐ |
| ☐ | **11** | **parakalonte** | ☐ |
| ☐ | **12** | **kthehej djathtas** | ☐ |
| ☐ | **13** | **kthehej majtas** | ☐ |
| ☐ | **14** | **ecte mbrapsht** | ☐ |
| ☐ | **15** | **qëndronte aty ku kalonte sensi i kundërt** | ☐ |
| ☐ | **16** | **vinte nga e djathta** | ☐ |
| ☐ | **17** | **nuk kishte vënë re shenjat e përparësisë apo semaforin e kuq** | ☐ |
| ☐ | | **Shëno në kuti numrin total të kryqeve të vendosura më lart** | ☐ |

## 13. grafiku i aksidentit

Tregoni: 1) planin e rrugëve; 2) drejtimin e udhëtimit te A e B; 3) pozicionin e tyre në momentin e përplasjes; 4) shenjat rrugore; 5) emrat e rrugëve

**15. Firmat e të dy drejtuesve**

**A** **B**

## Mjeti B (shkaktar)

B

**6. I siguruari** (kontrollo policën e sigurimit)
Emër_________________________
Mbiemër_______________________
Adresa________________________
Shteti_________________________
Email_________________________
Tel.__________________________

**7. Automjeti**
Marka dhe tipi_________________
Targa ose nr. i shasisë_____________

**8. Shoqëria e sigurimeve** __________
**Nr. i Policës**____________________
Nr. i Kartonit Jeshil_______________
(për të huajt) (sigla e vendit (nr.)
**Kontrata e sigurimit** | e vlefshme deri
ose **Kartoni Jeshil** | _______________
A është vetë mjeti i siguruar ( Kasko ) ?
**Po** ☐ **Jo** ☐

**9. Drejtuesi** ( Kontrollo dokumentet )
Emër_________________________
Mbiemër_______________________
Adresa________________________
Shteti_________________________
Email_________________________
Leje drejtimi nr._______________
Kategoria_____ lëshuar nga___________
____________________më____________
E vlefshme deri më_______________

**10. Shëno me kryq pikën fillestare të goditjes.**



**11. dëme materiale të dukshme**
______________________
______________________
______________________

**14. Vërejtje**______________________________
______________________________________
______________________________________

* **Nëse dikush është lënduar apo ka humbur jetën, njoftoni menjëherë Institucionet Shëndetësore në Nr. Tel. 112 dhe Policinë e Shtetit në Nr. Tel. 127.**
Nëse ka dëme materiale në objekte të ndryshme, përveç automjeteve A dhe B, përshkruani në rrethanat e aksidentit.
**Raportit duhet t'i bashkëngjiten dokumentat siç sqarohen në pjesën e pasme.**

## Informacione të tjera/Kërkesë për dëmshpërblim

**TË PLOTËSOHET NGA TË SIGURUARIT DHE TË NJOFTOHET SIGURUESI PËRGJEGJËS BRENDA 5 DITËVE NGA NDODHJA E RASTIT TË SIGURIMIT**

---

**Emri i të siguruarit (i dëmtuari)** _________________________ nr. telefoni _______________email______________________
**Siguruesi përgjegjës (shoqëria që ka lëshuar policën e shkaktarit të dëmit)** _________________________________
**Rrethanat e aksidentit** (përshkruaj të gjitha rrethanat e ndodhjes së aksidentit)

______________________________________________________________________
______________________________________________________________________
______________________________________________________________________
______________________________________________________________________
______________________________________________________________________
______________________________________________________________________
______________________________________________________________________

**Dëshmitarët**

| Nr. | Emër Mbiemër | Adresa | Telefoni | Statusi (pasagjer ose jo) | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |

**Në__________________ më ____/_____/__________** __________________________________
**Nënshkrimi i të siguruarit (i dëmtuari)**

**Kujdes!** Të përdoret për aksidentet rrugore nëse ka dëme ndaj pronës të cilat konsiderohen në vlerë deri 30 000 (tridhjetëmijë) lekë. Plotësimi i këtyre të dhënave konsiderohet **kërkesë për dëmshpërblim**, e cila shoqërohet dhe me dokumentat si më poshtë:

- Fotografi në momentin e aksidentit para lëvizjes së mjeteve nga një distancë e afërt dhe e largët (dëmtimin e mjeteve, gjurmët e frenimit, mbeturinat e rëna në rrugë) dhe gjurmët e rëndësishme si pozicioni i mjeteve, i rrotave etj.
- Fotografi të mjeteve të dëmtuara në mënyrë të qartë, pjesët e dëmtuara dhe targën e mjeteve;
- Dokumentat e identifikimit të palëve të përfshira në aksident (ID);
- Dokumentat e mjeteve dhe drejtuesve të tyre (leje qarkullimi, leje drejtimi, kopje e policave të sigurimit).

**Kujdes!** Mungesa e fotografive kërkon ekspertizën e mjetit të dëmtuar nga ana e shoqërisë së sigurimit përgjegjëse.
Rekomandojmë që Raportin Evropian të Aksidentit ta mbani në automjetin tuaj.
Ju lutemi, plotësoni me saktësi të dhënat e formularit dhe mbani parasysh që mashtrimi në sigurime është vepër penale.

**Si duhet vepruar në rast aksidenti?**
Sido që të jenë rrethanat, ruani gjakftohtësinë, qëndroni korrekt dhe plotësoni qetësisht e me kujdes së bashku me drejtuesin tjetër këtë Raport Evropian të Aksidentit.

**Plotësimi i formularit në vendin e aksidentit:**
1. Përdorni vetëm një Raport Evropian të ngjarjes për 2 mjete në secilin rast (2 për 3 mjete, etj). Pak rëndësi ka kush e jep vërtetimin miqësor dhe kush e plotëson atë. Preferohet të përdorni një stilolaps për të shkruar dhe shkruani në mënyrë të tillë që kopja të jetë plotësisht e lexueshme. Ky formular përdoret për trajtimin e një kërkese për dëmshpërblim vetëm pranë një shoqërie sigurimi.
2. Gjatë plotësimit të Raportit Evropian të Aksidentit për t'iu përgjigjur pyetjeve të rubrikave, mbani parasysh si më poshtë:
   a. në rubrikën 8 përdorni dokumentat tuaja të sigurimit (kontrata e sigurimit ose kartoni jeshil);
   b. në rubrikën 9 përdorni lejen tuaj të drejtimit (patenta e shoferit);
   c. në rubrikën 10 tregoni me saktësi pikën e goditjes fillestare;
   d. në rubrikën 12 vendosni një kryq (x) në kuti në drejtim të secilës prej rubrikave të rrethanave (nga nr. 1 deri në nr. 17) , që i përkasin aksidentit dhe tregoni gjithashtu numrin e shkaqeve të nënvizuar;
   e. në rubrikën 13 bëni një skicë të aksidentit.
3. Nënshkruani së bashku me drejtuesin e mjetit tjetër Raportin Evropian të Aksidentit.
4. Pagesa e dëmit nga shoqëria e sigurimit sipas Raportit Evropian të Aksidentit, shuan detyrimin e shoqërisë për pretendime të tjera lidhur me vlerën e dëmit.
5. Depozitoni këtë dokument pa vonesë **brenda 5 ditëve** nga data e aksidentit, tek siguruesi përgjegjës.

Trajtimi dhe pagesa e dëmshpërblimit nga shoqëria e sigurimit sipas Raportit Evropian të Aksidenteve, të nënshkruar nga dy drejtuesit, pa marrjen e procesverbalit të konstatimit të shkeljes nga Policia Rrugore, shuan detyrimin e shoqërisë për pretendime të tjera mbi vlerën 30 000 lekë, sipas nenit 14, të Ligjit 32/2021.